

Strasbourg, 1 dhjetor 2023

## **KËSHILLI KONSULTATIV I GJYQTARËVE EUROPIANË (CCJE)**

**Opinion Nr. 26 / 2023) i CCJE-së:**

**Lëvizja përpara:**

**përdorimi i teknologjisë ndihmëse në gjyqësor**

### **I. Hyrje**

1. Në përputhje me mandatin që i është besuar nga Komiteti i Ministrave, Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Europeanë (CCJE) ka përgatitur këtë Opinion të titulluar “Lëvizja përpara: përdorimi i teknologjisë ndihmëse në gjyqësor”.
2. Ky Opinion është përgatitur bazuar në Opinionet të mëparshme të CCJE-së, sidomos Magna Karta e CCJE-së për Gjyqtarët (2010) dhe Opinioni Nr. 14 (2011) për drejtësisë dhe teknologjitë e informacionit (TI). Duhet të lexohet së bashku me Opinioni Nr. 14 (2011), duke mbajtur parasysh se ky i fundit u përgatit në momentin kur përdorimi dhe natyra

e teknologjisë ishin në një fazë të hershme zhvillimi. Gjithashtu, dokumentet përkatëse të Këshillit të Europës janë marrë parasysh, p.sh Karta Etike Europiane e Komisionit European për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) mbi përdorimin e inteligjencës artificiale (AI) në sistemet gjyqësore dhe mjedisin e tyre (2018), Udhëzimet e CEPEJ për dosjet elektronike të gjykatave (e-dosje) dhe digjitalizimin e gjykatave (2021), Udhëzimet e CEPEJ për videokonferencën në procese gjyqësore (2021), Rekomandimin CM/Rec (2020) 1 e Komitetit të Ministrave mbi ndikimin e sistemeve algoritmike të drejtat e njeriut, Rekomandimin R (84) 5 e Komitetit të Ministrat mbi parimet e procedurës civile të krijuara për të përmirësuar funksionimin e drejtësisë (Parimi 9), Rezolutën e Asamblesë Parlamentare 2341 (2020) për nevojën për qeverisjen demokratike të inteligjencës artificiale, Raportin e Asamblesë Parlamentare mbi drejtësinë nga algoritmi - roli i inteligjencës artificiale në policimin dhe sistemet e drejtësisë penale (2020).

3. Vëmendje i është kushtuar edhe Teknologjive Digjitale për Drejtësi më të Mirë - Paketa me mjete për Veprim (2020) e Bankës Ndër-Amerikane për Zhvillim, Propozimit të Bashkimit European për një Rregullore të Parlamentit European dhe të Këshillit që përcakton rregulla të harmonizuara për inteligjencën artificiale (Akti i Inteligjencës Artificiale) dhe që ndryshon disa akte legjislativë të Bashkimit, dhe Rregullores (BE) 2016/679 së Parlamentit European dhe të Këshillit të 27 prillit 2016 për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave, dhe që shfuqizon Direktivën 95/46/EC (Rregullore e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave).
4. Në fund, Opinioni ka marrë parasysh përgjigjet e anëtarëve të CCJE-së për pyetësin për përgatitjen e Opinioni nr. 26 (2023) të CCJE-së. Përgjigjet tregojnë një gamë të gjerë të zhvillimit dhe përdorimit të teknologjisë. Të gjitha shtetet anëtare e përdorin atë deri diku. Kjo varion nga regjistrimi audio i proceseve deri te sistemet e dosjeve elektronike, menaxhimi elektronik i çështjeve dhe zhvillimi i videokonferencës, ku kjo e fundit ka avancuar veçanërisht në përdorim si pasojë e pandemisë Covid-19. Disa shtete anëtare janë duke shkuar drejt përdorimit 100% të dosjeve elektronike të çështjeve. Disponueshmëria e varianteve elektronike ose digjitale të vendimeve dhe legjislativës është gjithashtu një formë e zakonshme e përdorur të teknologjisë. Forma të automatizuara të proceseve, kur përdoren, janë shfrytëzuar në procese civile me vlera të ulëta (paditë e vogla) dhe për të lehtësuar vendimet dhe vendimet e gjykatave të tjera në çështje të thjeshta procedurale.
5. Përdorimi i inteligjencës artificiale (AI) në administrimin e drejtësisë mbetet në një fazë të sapokrijuar zhvillimi. Edhe pse nuk është përdorur nga një numër i madh i shteteve anëtare, kjo mundësi po eksplorohet në mënyrë aktive nga disa prej tyre. Aty ku përdoret, ka prirje të fokusohet në detyra administrative, p.sh. programe (diktimi) fjalë-tekst, përkthimi i gjuhës dhe anonimizimi automatik i vendimeve dhe urdhrave. Përgjigjet theksuan gjithashtu nevojën për t'u siguruar që përgjegjësia përfundimtare për vendimet gjyqësore t'i mbetet njeriut; AI duhet të mbështesë dhe jo të zëvendësojë gjyqtarët.
6. Në përfundim, Opinioni bazohet në një draft paraprak të përgatitur nga Eksperti i CCJE-së i emëruar nga Këshilli i Europës, Dr. John Sorabji (Asistent Profesor, Kolegji Universitar Londër).

## II. Qëllimi dhe objekti i Opinionit

7. Qëllimi i Opinionit është të shqyrtojë avantazhet dhe disavantazhet e përdorimit të teknologjisë ndihmëse në gjyqësor. Opinioni e pranon që përdorimi i teknologjisë në shoqëri do të vazhdojë të zhvillohet. Gjykatat dhe gjyqësori duhet të ndjekin ritmin me këto zhvillime. Gjithashtu, ai thekson rëndësinë e zhvillimit dhe përdorimit të teknologjisë në mënyra që ruajnë dhe, kur është e mundur, përforcojnë parimet bazë të shtetit të së drejtës. Për shembull, mund të përdoret për të mbështetur punën e gjyqtarëve dhe të palëve në proceset gjyqësore duke përmirësuar saktësinë në vendimmarrje. Gjithashtu mund të promovojë shpejtësinë dhe efikasitetin në administrimin e drejtësisë. Veçanërisht duhet të përmirësojë pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit të cilat të dyja garantohen në nivel ndërkombëtar nga Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)<sup>1</sup> si dhe nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut<sup>2</sup> dhe dokumente të tjera europiane dhe ndërkombëtare.<sup>3</sup>
8. Për të realizuar qëllimin e tij, Seksioni III i këtij Opinioni thekson përdorimin e përgjithshëm të teknologjisë, ndërsa Seksioni IV jep një pasqyrë për përdorimin specifik të saj, Seksioni V trajton avantazhet e mundshme të përdorimit të teknologjisë dhe Seksioni VI trajton sfidat dhe rreziqet që paraqet për pavarësinë e gjyqësorit. Nisur nga këto pika, Seksioni VII synon të japë një paketë të qëndrueshme me parime për përdorimin e ardhshëm të teknologjisë në gjyqësor. Termat e përdorur në Opinion përcaktohen në Fjalorth.
9. Objekti i Opinionit është i kufizuar në përdorimin e formave specifike të teknologjive moderne, duke përfshirë përdorimin e inteligjencës artificiale (AI) për të mbështetur gjykimin "njerëzor" që përdoren ose mund të përdoren nga gjyqësori, sidomos mjetet e të dhënave, dosjet dhe procedurat elektronike, sistemet e gjurmimit dhe menaxhimit të çështjeve, dhe audio dhe videokonferenca. Ai nuk mbulon transmetimin e proceseve në internet, përdorimin e vendimmarrjes së AI-së si zëvendësim për vendimet e marra nga njeriu ose përdorimin e teknologjisë nga dikush tjetër përveç gjyqësorit ose administratës së gjykatës.

## III. Përdorimi i përgjithshëm i teknologjisë

10. Nga shtetet kërkohet të sigurojnë qasje efektive dhe praktike në drejtësi.<sup>4</sup> Teknologjia është një mjet përmes së cilës ata mund ta bëjnë këtë, si në rrjedhën e zakonshme të punës ashtu edhe në rrethana të jashtëzakonshme ose emergjente. Prandaj është një nga mënyrat nëpërmjet të cilës një shtet demokratik, i përkushtuar për të siguruar sundimin e ligjit, mund të mundësojë ushtrimin e pushtetit gjyqësor të shtetit në çdo kohë.<sup>5</sup>
11. Aftësia e një shteti për të siguruar qasje në drejtësi përballet me sfida të shumta. Përballet me sfidën e burimeve. Të gjitha shtetet duhet të balancojnë shpërndarjen e

<sup>1</sup> Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, neni 6(1), Opinion nr. 14 / 2011) i CCJE-së, paragrafi 32.

<sup>2</sup> Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, neni 10.

<sup>3</sup> Karta e BE-së e të Drejtave Themelore, neni 47; Konventa Ndër-amerikane për të Drejtat e Njeriut, neni 8; Standardet Ndërkombëtare Mount Scopus për Pavarësinë Gjyqësore (2008, ndryshuar në 2012), parimi 1.1.

<sup>4</sup> Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) *Airey kundër Irlandës* (1979) 2 EHRR 305; *Tolstoy-Miloslavsky kundër Mbretërisë së Bashkuar* (1995) 20 EHRR 442 at [59].

<sup>5</sup> CCJE Opinion Nr. 14 (2011), paragrafi 5, 15, 19, 25 dhe 27.

burimeve në një sërë shërbimesh publike, ku gjykatat dhe gjyqësori janë një prej tyre. Përballet me sfidën e drejtësisë. Dhënia e drejtësisë duhet të bëhet në mënyrë të drejtë dhe në kohë pasi është mjeti me të cilin zbatohet e drejta materiale. Kjo vlen për të gjitha fushat e së drejtës. Vlen për paditë e vetme, por edhe kur ka një numër në rritje të padive në masë qofshin ato që fillojnë si padi të vetme ose si procese klasore ose kolektive. Vlen edhe për format tradicionale të mosmarrëveshjeve si edhe për numrin në rritje të formave të reja të mosmarrëveshjeve që lindin nga zhvillimi i tregjeve digjitale, tregtisë elektronike dhe krimeve elektronike.

12. Shtetet gjithashtu përballen me sfida emergjente për dhënien e drejtësisë dhe, nëpërmjet kësaj, për ruajtjen e shtetit të së drejtës. Emergjencat publike dhe kombëtare, qofshin ato të lidhura me shëndetin, siç është pandemia Covid-19 apo gjendje të tjera të jashtëzakonshme, paraqesin sfida të rëndësishme për administrimin e duhur të drejtësisë. Teknologjia, dhe veçanërisht mjetet e të dhënave, qofshin këto dosje dhe procedura elektronike, sisteme të gjurmimit dhe menaxhimit të çështjeve ose përdorimi i videokonferencës ose mjeteve të tjera, ofrojnë mënyrat me të cilat shtetet mund të japin drejtësi në rrjedhën normale të punës, d.m.th. dhënia e drejtësisë sipas ligjit. Është gjithashtu një mënyrë përmes të cilit mund të përballet me këto sfida të ndryshme.
13. Më gjerësisht, teknologjia gjithashtu ofron një bazë mbi të cilën gjyqësori, në parim, mund të zhvillojë një rol më të gjerë se sigurimi i drejtësisë sipas ligjit. Ajo mund të ndihmojë gjyqësorin të lehtësojë drejtësinë parandaluese, d.m.th. parandalimi i mosmarrëveshjeve përmes identifikimit të shkaqeve të tyre dhe marrja e hapave proaktivë për të ulur mundësinë e shfaqjes së atyre shkaqeve në të ardhmen.<sup>6</sup> Për shembull, kjo mund të arrihet përmes nxjerrjes së të dhënave të çështjeve nga vendimet publike në dispozicion ose të dhënat anonime nga rastet e zgjidhura për të identifikuar shkaqet e përgjithshme të mosmarrëveshjeve. Këto të dhëna më pas mund të analizohen dhe të formojnë bazën e reformës ligjore, e cila mund të ndihmojë në uljen e mundësisë së lindjes së këtyre mosmarrëveshjeve në të ardhmen. Ajo gjithashtu mund t'i ndihmojë të promovojnë zgjidhje me konsensus nëpërmjet zgjidhjes alternative dhe/ose në internet të mosmarrëveshjeve.<sup>7</sup> Të dyja këto mekanizma mund të lehtësohen nëpërmjet përdorimit të mjeteve të të dhënave siç janë sistemet e menaxhimit të çështjeve nga gjyqësori. Promovimi i njërit ose i të dyjave, veçanërisht, mund të luajë një rol të rëndësishëm në uljen e presionit për burime mbi gjykatat dhe gjyqësorin duke ulur numrin e mosmarrëveshjeve që kërkojnë menaxhimin dhe gjykimin e çështjeve.<sup>8</sup>

#### **IV. Përdorimi specifik i teknologjisë**

14. Ky Seksion përshkruan disa përdorime specifike të teknologjisë: mjetet e të dhënave, dosjet dhe procedurat elektronike, sistemet e gjurmimit dhe menaxhimit të çështjeve, seancat dëgjimore në distancë dhe hibride.

---

<sup>6</sup> R. Susskind, *Online Courts and the Future of Justice*, (OUP, 2019) at 113-115, ku në kuadër të zhvillimit të gjykatave në internet i referohet si 'promovimi i shëndetit ligjor'.

<sup>7</sup> Kjo përfshin zgjidhjen gjatë procedurave të ekzekutimit: Rekomandimi Rec (2003)17 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për ekzekutimin.

<sup>8</sup> *Alassini (Mjedisi dhe konsumatorët)* [2010] 3 CMLR 17 at [64]-[65]; *Menini dhe Rampanelli (Përafrimi i ligjeve Mbrojtja e konsumatorit: Vendim)* [2017] EUECJ C-75/16 (14 qershor 2017) në [61].

## **A) Instrumentet e të dhënave**

15. Gjyqësori përdor një gamë të gjerë të instrumenteve të të dhënave.

### **(i) Administrimi dhe menaxhimi i çështjeve**

16. Në nivel bazë, instrumentet e të dhënave përfshijnë përkthimin e gjuhës ose të provave, shërbimet e diktimit të zërit dhe transkriptimit, regjistrimin digjital të shënimeve, vendimeve dhe urdhrave të gjykatës. Ato mund të lehtësojnë gjithashtu përgatitjen e dokumenteve (përfshirë përmbledhjet e çështjeve), vlerësimin e provave, këtë të fundit për shembull, me anë të teknologjisë së zbulimit elektronik. Këto mund të rrisin administrimin efikas të çështjeve.
17. Më gjerësisht, nxjerrja e të dhënave nga dokumentet e çështjes mund të analizohet me instrumente të të dhënave për të ndihmuar në promovimin e qasjes në drejtësi duke ofruar informacion më të aksesueshëm për publikun.<sup>9</sup> Kjo mund të ndihmojë që sistemi ligjor të bëhet më efikas dhe më i aksesueshëm, veçanërisht për ata që mund të mos kenë njohuri ligjore ose burime të mjaftueshme. Gjyqësori mund të përdorë këto të dhëna për të ndihmuar Këshillin Gjyqësor dhe administratorët e gjykatave që të identifikojnë dhe të analizojnë karakteristikat e palëve në proces. Ky lloj analize mund të ndihmojë në identifikimin e barrierave ndaj qasjes për palët që kanë karakteristika<sup>10</sup> ose dobësi specifike. Më pas mund të përdoret nga gjyqësori si një bazë e shëndoshë provuese për ristrukturimin procedural dhe reformën, në përputhje me parimin e mosdiskriminimit dhe nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).
18. Instrumentet e të dhënave mund të nxjerrin dhe të ofrojnë bazën për analizën e informacionit të çështjes për të promovuar gjykimin efektiv të tyre. Ato mund të ndihmojnë gjyqtarët dhe administratorët e gjykatave të identifikojnë proceset që janë potencialisht të përshtatshme për procedura të shkurtuara ose të shkurtra, duke mundësuar që ato të përpunohen automatikisht dhe/ose të zgjidhen nëpërmjet mekanizmave të thjeshtuar të vendimeve gjyqësore.

### **(ii) Promovimi i zgjidhjeve**

19. Instrumentet e të dhënave mund të ndihmojnë gjithashtu gjyqësorin të promovojë zgjidhje. Analiza e karakteristikave të çështjeve mund të ndihmojë gjyqësorin të japë udhëzime për palët mbi format e mundshme të përshtatshme të procesit të zgjidhjes.
20. Ato mund të përdoren gjithashtu për të promovuar zgjidhjen përmes aplikimit të mjeteve të negociimit elektronik ose ndërmjetësimit elektronik. Këto procese mund të përfshihen në proceset gjyqësore ose të vihen në dispozicion përmes faqeve të internetit të gjykatave.<sup>11</sup> Zgjidhja, jo më pak nëpërmjet negociatave, mund të promovohet edhe me përdorimin e AI për të parashikuar rezultatin e mundshëm të procesit. Kjo mund të jetë e mundur të përfshihet në sistemet e menaxhimit të çështjeve.

---

<sup>9</sup> Kjo mund të lehtësohet për shembull nëpërmjet përdorimit të përpunimit të gjuhës natyrore (NLP).

<sup>10</sup> Si ato të përmendura në nenin 14 të KEDNJ-së.

<sup>11</sup> Tribunali i Zgjidhjeve Civile (British Columbia, Kanada).

### (iii) Vendimmarrja

21. Instrumentet e të dhënave kanë mundësi të luajnë një rol të gjerë që të ndihmojë vendimmarrjen gjyqësore.
22. Në nivelin më bazik, mjetet e të dhënave ndihmojnë në promovimin e kërkimit ligjor më të shpejtë dhe me kosto efektive dhe në përgatitjen e urdhrit dhe vendimit nga gjyqësori. Ato gjithashtu mund të ndihmojnë në identifikimin e të dhënave përkatëse, si dhe në ofrimin e modeleve të dokumenteve gjyqësore përmes nxjerrjes së informacionit nga çështjet.
23. Përdorimi i sistemeve të ekspertizës ose sistemeve të bazuara në të mësuarit e makinerive (AI mbështetëse) mund të ndihmojë gjithashtu vendimmarrjen gjyqësore. Ato mund të jenë në gjendje t'u ofrojnë gjyqtarëve vlerësime për themelin dhe/ose rezultate të parashikuara të proceseve. Duke qenë në gjendje t'u japin gjyqtarëve vlerësimet e themelit, ato mund të jenë një mjet për të ndihmuar gjyqtarët që të vlerësojnë konkluzionet e tyre.
24. Mund të jenë në gjendje të përdoren për të ndihmuar vendimmarrjen gjyqësore në mënyra të tjera. Disponueshmëria e vendimeve gjyqësore dhe legjislacionit është një formë bazë e mjetit të të dhënave. Ato variojnë në aplikim nga faqet e internetit të përgjithshme që përmbajnë thjesht praktikën gjyqësore dhe legjislacionin me funksionin bazë të kërkimit të fjalëve kyçe dhe tekstit deri te bazat e të dhënave më të sofistikuar që ofrojnë lidhje efektive hiperteksti me praktikën dhe legjislacionin tjetër gjyqësor. Këto përgjithësisht vihen në dispozicion nga Shtetet Anëtare ose nga ndërmarrjet private; këto të fundit kanë tendencën të ofrojnë mjete më të sofistikuar. Kur gjyqësori i vë në dispozicion, ato promovojnë vendimmarrje efektive gjyqësore dhe gjithashtu ndihmojnë në sigurimin e llogaridhënies demokratike të gjyqësorit. Ato e sigurojnë këtë të fundit ku i vënë vendimet në dispozicion të publikut.<sup>12</sup>
25. Kur këto dokumente janë të lexueshme nga makineria, mund të krijohet funksionaliteti bazë i fjalëve kyçe. Sistemet e bazuara në të mësuarin e makinerive mund të ofrojnë kërkim nëpër dhe brenda vendimeve. Kjo mund t'i japë gjyqësorit akses në forma smart të kërkimit ligjor, duke rritur aftësinë e tyre për të analizuar kuadrin ligjor kompleks, sidomos statutet dhe rregulloret administrative, si edhe jurisprudencën europiane, kombëtare dhe krahasuese, dhe legjislacionin e butë (soft). Kjo mund të ndihmojë në zhvillimin e vendimmarrjes gjyqësore.
26. Kërkimi smart mund të ofrojë qasje në linja argumenti të reja ose të paignifikuar më parë. Njohja e këtyre argumenteve nga palët mund t'i ndihmojë ato të përmirësojnë cilësinë dhe kreativitetin e parashtrimeve të tyre, duke kontribuar kështu në cilësinë e vendimmarrjes gjyqësore.
27. Anasjelltas, kjo analizë mund t'i ndihmojë gjyqtarët të identifikojnë argumentet që zakonisht përdoren nga palët për çështje specifike dhe vendime që kanë të bëjnë me to. Kjo ndihmë mund të rrisë besimin dhe legjitimitetin e gjyqësorit nëpërmjet promovimit të qëndrueshmërisë në vendimmarrje.

---

<sup>12</sup> CCJE Opinion nr. 18 (2015), paragrafët 27-28 dhe 32. Ndërmarrja private mund dhe jep gjithashtu akses në këtë informacion.

## **B) Dosjet dhe procedurat elektronike**

28. Dosjet dhe procedurat elektronike janë një parakusht bazë për përdorimin efektiv të teknologjisë në gjyqësor. Ato mbështesin sistemet mbështetëse të gjyqësorit. Këto procese përdoren gjerësisht, qoftë si pjesë e sistemeve të përziera (fizike dhe dosje dhe procedura elektronike) ose si pjesë e sistemeve vetëm elektronike. Ato përfshijnë gjithashtu përdorimin e nënshkrimeve digjitale, elektronike ose vulave me kohë elektronike në dokumente dhe procese të kryera në mënyrë elektronike.
29. Kjo teknologji mund të përdoret në të gjitha fazat e procesit. Proceset mund të iniciohen në internet përmes dosjeve elektronike. Njoftimi mund të bëhet në mënyrë elektronike ose përmes postës elektronike, një aplikacioni të bazuar në ueb (App) ose formave të tjera të teknologjisë. Sistemet e gjurmimit dhe menaxhimit të çështjeve lehtësohen përmes procedurave elektronike dhe dosjeve digjitale të menaxhimit të çështjeve. Ekzekutimi mund të kryhet gjithashtu nëpërmjet procedurave elektronike, qoftë të kryera nga ose në emër të një gjykate ose nga një palë e tretë, si p.sh një përmbarues.<sup>13</sup> Përdorimi i kësaj teknologjie ka disa avantazhe.
30. Përdorimi i tyre mund të nxisë gjithashtu standardizimin administrativ dhe procedural nëpër gjykatat të shkallës së parë dhe të apelit dhe tribunale. Standardizimi mund të çojë në caktimin me kosto më efektive dhe më efikas të stafit administrativ në mbështetje të gjyqësorit.
31. Përdorimi i tyre mund të çojë edhe në rivlerësimin e proceseve. Proceset e panevojshme dhe joefikase mund të eliminohen, duke reduktuar sërish kostot administrative dhe kohën. Dokumentet shkresore, për shembull, nuk do të kenë më nevojë të depozitohen, të merren ose të transportohen. Dosjet elektronikë janë të disponueshme në çdo kohë ose vendndodhje. Kjo mund të nxisë një menaxhim më efikas të çështjeve gjyqësore. Gjithashtu, potencialisht mund të promovojë modele më fleksibël të punës në radhët e gjyqësorit.
32. Përdorimi i kësaj teknologjie mund të rezultojë gjithashtu në qasje më ekonomike dhe efikase ndaj dokumenteve të çështjes nga palët dhe avokatët e tyre. Kështu, mund të ndihmojë gjyqësorin të promovojnë akses më të madh në drejtësi. Duke siguruar mjetet për të aksesuar proceset nga një zyrë, nga shtëpia ose tjetër, mund të sigurohet veçanërisht barazi më e madhe procedurale.

## **C) Sisteme të gjurmimit dhe menaxhimit të çështjeve**

33. Përdorimi i sistemeve të gjurmimit dhe menaxhimit të çështjeve, si pjesë e sistemeve mbështetëse të gjyqësorit, i shërben një sërë funksioneve.

### **(i) Administrimi**

34. Nga këto sisteme mund të nxirret Informacioni i menaxhimit administrativ dhe gjyqësor. Kjo mund të ndihmojë në lehtësimin e vlerësimit, nga ana e gjyqësorit, të përdorimit të burimeve gjyqësore dhe të gjykatës. Mund të ofrojë të dhëna efektive për krijimin dhe aplikimin e Treguesve Kryesor të Performancës për sistemet e drejtësisë, p.sh. në aspektin e efikasitetit, efektivitetit të kostos dhe aksesueshmërisë.<sup>14</sup>

---

<sup>13</sup> Nëpunësit e ekzekutimit përfshijnë, për shembull, përmbaruesit dhe huissiers de justice.

<sup>14</sup> Treguesit kryesorë të performancës (KPI) janë një mjet me të cilin mund të vlerësohet performanca. Ato bazohen në të dhëna të matshme. Për shembull, kur bëhet fjalë për gjyqësorin, KPI-të mund të lidhen me kohëzgjatjen e nevojshme për të dhënë një vendim pas përfundimit të procesit. Shihni gjithashtu Udhëzimet e

35. Këto masa mund të nxisin shpërndarjen më të informuar të burimeve, buxhetit dhe planifikimin e radhës së punës (duke përfshirë shpërndarjen efektive të punës për gjyqtarët dhe administratorët e gjykatave) dhe planifikimin e burimeve në të ardhmen.<sup>15</sup>Kjo mund të jetë veçanërisht e dobishme kur këto sisteme janë të ndërveprueshme në të gjithë sistemin e drejtësisë. Gjithashtu mund të lehtësohet qasja gjithëpërfshirëse dhe vlerësimi i menaxhimit të burimeve në të gjitha aspektet e sistemit të drejtësisë.
36. Kur informacioni nga sistemet e gjurmimit dhe menaxhimit të çështjeve vihet në dispozicion të publikut, p.sh. nëpërmjet regjistrave publikë online, planifikimit të orareve dhe informacionit të seancave dëgjimore, gjyqësori mund të rrisë gjithashtu përgjegjshmërinë e tij ndaj publikut.

### **(ii) Planifikimi kohor efektiv dhe planifikimi i seancave dëgjimore**

37. Në një nivel bazë, këto sisteme mund të lehtësojnë planifikimin kohor procedural nga gjyqësori. Thjesht, kjo mund të arrihet përmes ofrimit të aksesit në informacion në lidhje me statusin dhe ecurinë e proceseve individuale.
38. Në një nivel më të lartë, këto sisteme mund të përmirësojnë planifikimin kohor dhe të seancave dëgjimore. Inteligjenca artificiale mbështetëse mund të përdoret për të përcaktuar përdorimin optimal të kohës gjyqësore për t'u marrë me çdo grup procesesh për të cilat gjykatat kanë përgjegjësi. Kjo mund të përfshijë ofrimin e modeleve për planifikimin kohor procedural ose udhëzime për çdo çështje.

### **(iii) Shpërndarja e çështjeve**

39. Sistemet e planifikimit mund të ofrojnë gjithashtu mundësinë e shpërndarjes së automatizuar të çështjeve te gjyqtarët përmes zbatimit të kriterëve të miratuara nga gjyqësori dhe që i nënshtrohen mbikëqyrjes dhe vendimmarrjes gjyqësore. Kjo gjithashtu mund të ndihmojë në lehtësimin e përdorimit optimal të ndërtesave të gjykatës dhe sallave të gjykimit.

### **(iv) Monitorimi i respektimit**

40. Pasi të jetë caktuar një plan kohor procedural optimal, sistemet e menaxhimit të çështjeve mund të promovojnë monitorim efektiv dhe me kosto efektive të respektimit.<sup>16</sup> Ato mund t'u ofrojnë gjyqtarëve dhe palëve rikujtesa automatike për afatet e ardhshme procedurale. Këto rikujtesa mund të lehtësojnë menaxhimin efektiv. Ato janë gjithashtu në gjendje të nxisin respektimin. Mund të lajmërojnë edhe gjyqtarët për dokumentet që depozitohen. Përveç promovimit të ekonomisë dhe efikasitetit, këto masa mund të nxisin dhënien në kohë të drejtësisë nga gjyqësori, që në vetvete mund të nxisë gjykimin dhe ekzekutimin efektiv.
41. Automatizimi, veçanërisht kur bëhet fjalë për rikujtesat e respektimit, dhe ofrimi i informacionit të standardizuar për gjyqtarët, mund të nxisë qëndrueshmëri më të madhe në menaxhimin e çështjeve. Për rrjedhojë kjo mund të nxisë legjitimitetin dhe besimin e publikut te gjyqësori.

---

Komisionit European për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) për matjen e cilësisë së drejtësisë (2016).

<sup>15</sup> Digital Technologies for Better Justice – A Toolkit for Action (2020) of the Inter-American Development Bank në 22-23.

<sup>16</sup> Duhet theksuar që efikasiteti dhe ekonomia nuk janë qëllime në vetvete. Ato janë një mjet për të promovuar qasjen në drejtësi.



#### **(v) Menaxhimi i padive në masë**

42. Sistemet e menaxhimit të çështjeve mund të promovojnë gjithashtu identifikimin, grupimin dhe menaxhimin e çështjeve testuese dhe/ose padive në masë.
43. Në rastin e një numri të madh padish individuale që ngrenë çështje ligjore ose faktike të njëjta ose të ngjashme, sistemet e menaxhimit të çështjeve mund të ndihmojnë në uljen e presionit mbi burimet e gjykatave dhe gjyqtarëve duke i identifikuar dhe grupuar ato si një padi në masë, e cila rrjedhimisht mund të transferohet, nëpërmjet kuadrit të procedurës, në një gjykatë të vetme menaxhimi dhe të menaxhohet si padi kolektive, grupi ose përfaqësuese.
44. Rrjedhimisht, menaxhimi i automatizuar i çështjeve për këto padi mund të promovojë menaxhimin dhe zgjidhjen e tyre efikase, me kosto efektive dhe proporcionale. Mund të promovojë gjithashtu skema efektive të zgjidhjeve masive. Identifikimi dhe grupimi i gatshëm i këtyre çështjeve promovon konsistencën e praktikës gjyqësore, pasi ul rrezikun që çështjet ligjore ose faktike të njëjta ose të ngjashme të zgjidhen ndryshe nga gjyqtarë të ndryshëm.
45. Menaxhimi efikas mund të promovohet gjithashtu nëpërmjet identifikimit të një padie të vetme mes një numri të madh padish të ngjashme, e cila më pas mund të kalojë në gjykim si një çështje testuese ose kryesore. Kjo mund të lehtësohet nëpërmjet mjeteve të të dhënave që nxjerrin informacion nga çështjet e depozituara për të identifikuar çështjet më të përshtatshme që shkojnë për gjykim mbi këtë bazë.

#### **(vi) Identifikimi dhe vlerësimi i problemeve dhe provave**

46. Mjetet e të dhënave të tilla si ato që përdoren në teknologjitë parashikuese<sup>17</sup> (e-zbulimi ose zbulimi elektronik) brenda një sistemi mbështetës të gjyqësorit, mund të përdoren për të identifikuar provat kryesore që janë ngarkuar në sistemin e menaxhimit të çështjeve nga palët. Kjo mund të ndihmojë më mirë gjyqtarët që të identifikojnë dhe të marrin në konsideratë çështje faktike në mënyrë më efektive.
47. Kjo teknologji është veçanërisht e rëndësishme kur bëhet fjalë për provat elektronike. I tillë është veçanërisht rasti në proceset penale, të tilla si krimi i jakave të bardha dhe ku bëhet fjalë për analizën e të dhënave të telefonit celular në lidhje me krimet kundër personit. Pa përdorimin e kësaj teknologjie, ekzaminimi dhe vlerësimi i këtyre provave po bëhet gjithnjë e më intensiv sa i përket burimeve dhe kohës. Menaxhimi i automatizuar i çështjeve mund të ndihmojë më pas gjetjen e fakteve gjyqësore në këto çështje. Kështu, ai mund të përmirësojë saktësinë e gjykimit, si dhe të ulë koston dhe kohën e nevojshme për gjykimin.

#### **(vii) Drejtësia transparente dhe llogaridhënia**

48. Vënia në dispozicion të publikut dhe medias e informacionit për gjurmimin e çështjeve mundëson një kontroll efektiv të natyrës dhe llojeve të mosmarrëveshjeve që sillen në gjykatë, si edhe të vendimeve dhe urdhrave. Mundëson kontrollin e ecurisë së çështjes. Këto sisteme janë kështu edhe një mjet me të cilin gjyqësori mund të promovojë llogaridhënie procedurale transparente.<sup>18</sup>
49. Sistemet e automatizuara të menaxhimit të çështjeve mund të sigurojnë gjithashtu që çdo shmangie e nevojshme nga drejtësia transparente të bëhet në mënyrë efektive. Kështu, ato mund të ndihmojnë gjyqësorin të sigurojë përmbushjen e çdo detyrimi që

<sup>17</sup> Të tilla si kodimi parashikues, i cili përdoret nga palët në disa shtete anëtare për të kryer zbulimin elektronik.

<sup>18</sup> CCJE Opinion nr. 18 (2015), paragrafët 27-30.

lind në këtë aspekt nga nenet 6 dhe 8 të KEDNJ-së.

#### **D) Seanca dëgjimore hibride**

50. Audio dhe videokonferenca janë mjete të konsoliduara për zhvillimin e seancave, pavarësisht nga objekti. Ato bëjnë të mundur mbajtjen e seancave hibride ose në distancë.
51. Megjithatë, pandemia Covid-19 e ka zgjeruar ndjeshëm përdorimin e kësaj teknologjie. Shtetet ose po zhvillojnë dhe përdorin teknologjinë e tyre ose po përdorin teknologjinë në dispozicion në treg për zhvillimin e këtyre seancave. Përdorimi i tyre ka disa përfitime të mundshme.
52. Ato mund të ulin koston dhe kohën e nevojshme për t'u marrë me proceset. Ato mund të lehtësojnë caktimin më efikas të seancave, duke eliminuar kohën e udhëtimit dhe pritjes në ndërtesat e gjykatave. Kjo mund të nxisë proporcionalitetin procedural. Një seancë dëgjimore me prezencë fizike mund të gjenerojë kosto joproporcionale financiare dhe të përkohshme në seancat dëgjimore të shkurtra, të bazuara në letër, të ndërmjetme ose të menaxhimit të çështjeve. E njëjta gjë mund të thuhet për seancat që përfshijnë vetëm argumentim ligjor. Përdorimi i tyre mund të nxisë qasjen në drejtësi.
53. Seancat hibride gjithashtu mund të nxisin pjesëmarrjen efektive si nga gjyqtarët ashtu edhe nga palët. Në mënyrë të veçantë, kur bëhet fjalë për gjyqtarët, ata mund të ndihmojnë në promovimin e modeleve të punës me kohë të pjesshme dhe fleksibël. Në këtë mënyrë kënaqësia e tyre në punë dhe mundësitë e karrierës në radhët e gjyqësorit mund të rriten.
54. Kur bëhet fjalë për gjyqtarët dhe palët, ata mund të lehtësojnë pjesëmarrjen në seanca nëse karakteristikat e tyre personale, shëndeti ose rrethana të tjera mund ta bëjnë të vështirë pjesëmarrjen fizikisht në një seancë. Një palë e cenueshme, veçanërisht në proceset penale ose familjare, për shembull, mund të jetë në gjendje të marrë pjesë në mënyrë efektive në distancë nga shtëpia ose nga një pjesë tjetër e ndërtesës së gjykatës. E njëjta gjë vlen, në përgjithësi, për personat me aftësi të kufizuara. Seancat hibride në këtë mënyrë mund të promovojnë barazinë procedurale si dhe qasjen në drejtësi në përgjithësi.

#### **V. Sfidat që lindin nga përdorimi i teknologjisë**

55. Neni 6 i KEDNJ-së parashikon, ndër të tjera, një gjyqësor të pavarur.<sup>19</sup> Ai kërkon që gjyqësori të jetë i pavarur nga pushteti ekzekutiv<sup>20</sup> dhe pushteti legjislativ. Ai gjithashtu duhet të jetë i pavarur nga palët në proces.<sup>21</sup> Gjithashtu gjyqësori duhet të jetë i paanshëm.<sup>22</sup> Në të dyja rastet, gjyqësori jo vetëm që duhet të jetë i pavarur dhe i paanshëm, por gjithashtu duhet të shihet si i tillë.<sup>23</sup> Pavarësia gjyqësore, si në aspektin institucional ashtu edhe në atë individual,<sup>24</sup> nuk ekziston për të mirën e gjyqësorit, as paanshmëria.

---

<sup>19</sup> CCJE Opinion vr. 3 (2002), para 9; CCJE Magna Carta e Gjyqtarëve (Parime Themelore) (CCJE (2010)3), paragrafët 2-3.

<sup>20</sup> *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës* [2002] GJEDNJ 626 në [80].

<sup>21</sup> *Ringelsen kundër Austrisë* [1971] GJEDNJ 2 në [95].

<sup>22</sup> *Kyprianou kundër Qipros* [2005] GJEDNJ 873 në [118]; *Piersack kundër Belgjikës* [1982] GJEDNJ 6 në [30].

<sup>23</sup> *Sramek kundër Austrisë* [1984] GJEDNJ 12 në [42]; *Kyprianou kundër Qipros* [2005] GJEDNJ 873 në [121].

Shihni në lidhje me BE-në, *Associacao Sindical dos Juizes Portugueses* [2018] EUECJ C-64/16 në [44].

<sup>24</sup> Këshilli i Europës, Rekomandim (2010) 12 për gjyqtarët, pavarësinë, efikasitetin dhe përgjegjësitë, Kreu 2 dhe 3, ku këto dallime përmenden si pavarësi e jashtme dhe e brendshme, përkatësisht.

## **(A) Sfida thelbësore**

### **(i) Sfida e pavarësisë gjyqësore**

56. Zbatimi i reformës teknologjike në disa shtete anëtare është përgjegjësi e ekzekutivit. CCJE ka pranuar më parë se gjyqësori duhet të ketë një rol dhe përgjegjësi në këtë drejtim për të siguruar pavarësinë e gjyqësorit.<sup>25</sup> Nuk mund të nënvlerësohet potenciali që ka dizajni teknologjik për të formësuar qasjen në drejtësi, qoftë me vetëdije apo pa vetëdije. Mjetet e të dhënave në zhvillimin e treguesve kryesorë të performancës mund të përdoren për të minuar menaxhimin e çështjeve gjyqësore nëpërmjet vendosjes së objektivave të bazuara në efikasitet që janë në dëm të autonomisë në vendimmarrjen gjyqësore. Për më tepër, ato mund të përdoren për të kritikuar në mënyrë të pahijshme anëtarët e gjyqësorit të cilët nuk kanë arritur të përmbushin ato objektiva, duke goditur kështu pavarësinë e gjyqësorit në nivel individual dhe institucional. Gjithashtu, zhvillimi i parametrave të sistemit të bazuar në teknologji, rikuqtesave ose AI mund të ulë autonominë gjyqësore në vendimmarrje. Në raste ekstreme, ata mund ta bëjnë këtë në mënyra që janë në kundërshtim me sundimin e ligjit.
57. Masat efektive të sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave kërkojnë mbikëqyrje efektive dhe të pavarur të teknologjisë së përdorur nga gjyqësori, siç bëjnë përgjithësisht në shoqëri.<sup>26</sup> Kjo mbikëqyrje mund të përbëjë një risk të konsiderueshëm ndaj pavarësisë së gjyqësorit nëse do të kryhej nga ekzekutivi ose një organ rregullator, si Mbikëqyrësi Kombëtar i Mbrojtjes së të Dhënave, dhe jo nga një organ brenda gjyqësorit.
58. Për t'u kthyer tek AI, lindin disa sfida për pavarësinë e gjyqësorit. Projektimi algoritmik mund të dëmtojë pavarësinë gjyqësore kur gjyqësori nuk ka input dhe mbikëqyrje të informuar dhe efektive mbi të. I tillë mund të jetë veçanërisht rasti kur shtetet anëtare kontraktjnë projektimin dhe zbatimin nga kompani private, sidomos pasi kontrolli i AI-së synon të përqendrohet në duart e një numri të vogël kompanish. Ky është një shembull diskret dhe akut i rrezikut të projektimit. Gjithashtu, kur sistemet e menaxhimit të çështjeve përdorin AI për të caktuar seancat, kjo mund të bëhet në mënyra që përfshijnë paragjykim në planifikimin e seancave që dëmton kontrollin gjyqësor mbi këtë funksion.<sup>27</sup>
59. Përdorimit të AI për të ndihmuar menaxhimin e çështjeve ose për të ndihmuar vendimmarrjen gjyqësore mund t'i mungojë transparenca mbi atë se çfarë dhe si përdoret informacioni nga një teknologji e tillë. Transparenca e ulur mund të pengojë llogaridhënien shpjeguese dhe apeluese të gjyqësorit.<sup>28</sup> Kjo mund të vërë në pikëpyetje pavarësinë e gjyqësorit dhe legjitimitetin e gjyqësorit, si në nivel individual ashtu edhe institucional.
60. Marrja e vendimeve gjyqësore është një aktivitet shumë i kualifikuar. Kërkon trajnim të konsiderueshëm dhe përvojë. Përdorimi i mjeteve të të dhënave si një zëvendësim për kërkimin ligjor gjyqësor dhe i AI mbështetëse për të ndihmuar gjyqtarët të marrin

<sup>25</sup> CCJE Opinion nr. 14 (2011), paragrafët 32 dhe 36.

<sup>26</sup> Rregullore (BE) 2016/679 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 27 prillit 2016 për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave dhe që shfuqizon Direktivën 95/46/EC (Rregullore e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave).

<sup>27</sup> Njëanshmëria mund të rezultojë në shpërndarjen e çështjeve në mënyrë jo rastësore, por sipas karakteristikave të palëve.

<sup>28</sup> CCJE Opinion nr. 18 (2015), paragrafët 27-29.

vendime mund të dëmtojë aftësinë e një gjyqtari individual për të bërë kërkime dhe për të marrë vendime. Përdorimi i kodimit parashikues, për shembull, mund të dëmtojë aftësinë e gjyqtarit për të përcaktuar se çfarë është dhe çfarë nuk është provë e rëndësishme dhe mund të ndikojë negativisht në aftësinë e tyre për të vlerësuar fuqinë e provave. Ndërsa këto mjete synohet të ndihmojnë vendimmarrjen gjyqësore, ato me kalimin e kohës mund të ulin aftësitë dhe përvojën gjyqësore.

61. Një pasojë e mundshme që gjyqtarët nuk janë më në gjendje të identifikojnë dhe të vlerësojnë fuqinë e provave është se ata mund të bëhen të varur nga asistenca teknologjike. Nëse aftësitë dhe përvoja e tyre në marrjen dhe identifikimin e provave dhe fusha të ngjashme do të zhvishej nga mbështetja në teknologji siç është kodimi parashikues, pavarësia individuale dhe autonomia gjyqësore, mund të ulej. Kështu që ajo që synohet të jetë mbështetëse mund të bëhet vendim *de facto*. Kjo mund të jetë veçanërisht problematike kur kjo asistencë u ofron gjyqtarëve individual një vlerësim të normave të vendimmarrjes bazuar në tendencat e përgjithshme në radhët e gjyqësorit; një problem që më pas do të përforcohej pasi më shumë gjyqtarë do të ndiqnin trendin e identifikuar nga mjetet e të dhënave. Më gjerësisht, kjo përbën një kërcënim për pavarësinë institucionale pasi në fakt do ta vendoste procesin e vendimmarrjes në duart e atyre që krijojnë mjetet e të dhënave.

## **(ii) Sfida e gjykimit të drejtë**

62. Teknologjia paraqet disa sfida për aftësinë e gjyqësorit për të siguruar të drejtën e palëve për një gjykim të drejtë të garantuar nga neni 6 i KEDNJ-së.
63. Përdorimi i mjeteve të të dhënave, veçanërisht kur ato përfshijnë AI mbështetëse, mund të ndikojë negativisht në aftësinë e gjyqësorit për të siguruar një gjykim të drejtë për palët. Mjetet e të dhënave, të tilla si Chatbots, mund të prodhojnë për shembull rezultate të rreme, p.sh. ato mund të krijojnë praktikë gjyqësore fiktive që mund të rezultojë në gabim gjyqësor. Përdorimi i AI mund të dëmtojë gjithashtu kontrollin e gjyqësorit mbi shpërndarjen e çështjeve.
64. Megjithatë, duhet pasur kujdes kur bëhet fjalë për seancat dëgjimore hibride. Përfitimet e qasjes në drejtësi mund të mos realizohen lehtësisht kur bëhet fjalë për gjykimet ose seancat përfundimtare, veçanërisht kur ato përfshijnë marrjen dhe vlerësimin e dëshmimeve të dëshmitarëve. Në rastin e fundit, në varësi të rrethanave, mund të jetë e nevojshme të mbahet një seancë dëgjimore me prani fizike për të marrë dhe testuar dëshmitë dhe për të siguruar një gjykim të drejtë, pasi ky është mjeti i duhur efektiv me të cilin mund të realizohet.
65. Seancat hibride paraqesin gjithashtu rrezikun që palët dhe dëshmitarët mund të udhëhiqen nga individë jashtë kamerave, gjë që mund të korruptojë procesin e gjykimit. Gjithashtu, ato paraqesin rrezikun që seancat dëgjimore të mos sigurojnë barazinë e armëve. Pjesëmarrja e diferencuar mund të jetë në të mirë ose jo të një pjesëmarrësi ndaj një tjetri, veçanërisht kur provat e dëshmitarëve vlerësohen, në varësi të faktit nëse ata janë fizikisht të pranishëm në gjykatë ose marrin pjesë nëpërmjet audio ose videokonferencës. Në proceset penale, ku i pandehuri merr pjesë përmes videokonferencës dhe avokati i tij nuk është i pranishëm personalisht, mund të lindin pyetje nëse ata janë në gjendje të marrin këshilla ligjore në mënyrë konfidenciale gjatë një seance.<sup>29</sup>

---

<sup>29</sup> *Sakhnovskiy kundër Ruisisë* [2010] GJEDNJ 1673; *Sakhnovskiy kundër Ruisisë* ( [2018] GJEDNJ 966; *Marcello Viola kundër Italisë* (Nr. 45106/04) (5 tetor 2006) në [67]-[77]; *Gorbunov kundër Ruisisë* [2016] GJEDNJ 231.

66. Audio dhe videokonferencat përbëjnë gjithashtu një rrezik për aftësinë e gjyqësorit për të përmbushur detyrën e tij që të sigurojë drejtësi transparente. Teknologjia mund ta pengojë këtë nëse aksesueshmëria nuk është e integruar në mënyrë efektive.<sup>30</sup> Në të kundërt, qasja e publikut dhe e medias në seancat e mbajtura nëpërmjet videokonferencës mund të krijojë presion mbi gjyqtarët. Natyra dhe cilësia e kontrollit të vazhdueshëm ku të gjitha seancat vihen në dispozicion online mund të pengojnë vendimmarrjen gjyqësore, sidomos duke komprometuar një zonë thelbësore të privatësisë dhe reflektimit që gjyqtarët kanë nevojë për të përmbushur në mënyrë efektive përgjegjësitë e tyre.
67. Një zhvendosje e konsiderueshme nga seancat fizike në ato hibride ose në distancë mund të dëmtojë gjithashtu statusin kushtetues të procesit gjyqësor, veçanërisht natyrën e tij simbolike.<sup>31</sup> Pjesëmarrja në procese nga shtëpia, në makinë ose në një hapësirë publike mund të dëmtojë të kuptuarin nga shoqëria të rëndësisë qytetare të procesit. Kështu, statusi dhe legjitimiteti i gjyqësorit në nivel institucional si pjesë e shtetit mund të dëmtohet. Në lidhje me proceset individuale, kjo mund të bëjë që pjesëmarrësit të mos i marrin proceset aq seriozisht sa duhet. Kjo mund të ketë një ndikim negativ në natyrën dhe cilësinë e provave, veçanërisht dëshmitë e dëshmitarëve nën betim, të cilat gjithashtu mund të komprometojnë aftësinë e gjyqësorit për të siguruar gjykime të drejta.

## **(B) Sfida të tjera**

### **(i) Sfida e projektimit**

68. Teknologjia mund të inkorporohet në gjykata dhe gjyqësor në disa mënyra. Ajo mund të replikojë proceset para-digjitale. Rreziku i natyrshëm është që një preferencë për status quo-në do të ngulitë në sistemet e ardhshme çdo të metë projektimi që ekziston në praktikat dhe procedurat aktuale. Nëse do të bëhet automatizimi, duhet pasur kujdes për të testuar nëse ajo që është bërë aktualisht duhet të përsëritet siç duhet teknologjikisht. Gjithashtu, disa forma të teknologjisë, veçanërisht ato të parashikuara për vendimet e gjurmimit dhe menaxhimit të çështjeve mund të kërkojnë kontribut gjyqësor për të siguruar projektimin e duhur. Duhet pasur kujdes që të sigurohet një kontribut i tillë.
69. Gjithashtu, përdorimi i teknologjisë mund të zgjerojë rolin e gjyqësorit. Kjo mund të bëhet duke u mundësuar sistemeve gjyqësore përfshirjen e drejtësisë parandaluese dhe konsensuale në proceset gjyqësore. Rreziku këtu është që roli kushtetues i gjyqësorit mund të cenohet. Roli kushtetues i gjyqësorit mund të ngatërrohet me atë të një shërbimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të një shërbimi për konsumatorin.
70. Teknologjia gjithashtu nuk është neutrale ndaj projektimit. Ajo mbart rrezikun e natyrshëm të projektimit, zbatimit dhe përdorimit diskriminues. Projektimi mund të diskriminojë palët për shkak të racës, përkatësisë etnike, seksit ose gjinisë. Mund të ndikojë gjithashtu negativisht, për shembull, te neuro-diversiteti ose personat me probleme në shikim ose dëgjim. Kjo mund të lindë ose nëpërmjet projektimit diskriminues ose nëpërmjet përdorimit të të dhënave në sistemet mbështetëse të gjyqësorit që në vetvete janë diskriminuese ose të dyja. Mund të pengojë gjithashtu qasjen në drejtësi për ata që janë në disavantazh teknologjik, kur nuk mund ta përdorin ose të kenë qasje në teknologji në mënyrë efektive.
71. Prandaj, sfida kryesore është të sigurohet që projektimi teknologjik të jetë në

<sup>30</sup> *Micallef kundër Maltës* [2009] GJEDNJ 1571.

<sup>31</sup> CCJE Opinion nr. 14 (2011), paragrafi 6.

përputhje me parimin e mosdiskriminimit dhe me nenet 6 dhe 8 të KEDNJ, duke ruajtur statusin kushtetues të gjyqësorit.

## **(ii) Sfida e zbatimit**

72. Projektimi efektiv duhet të plotësohet me zbatimin efektiv, i cili kërkon angazhimin aktiv, përfshirjen dhe trajnimin pasues të gjyqtarëve.
73. Nëse përdorimi i teknologjisë do të realizojë plotësisht përfitimet ekonomike dhe të efikasitetit, dosjet dhe procedurat elektronike, sistemet e gjurmimit dhe menaxhimit të çështjeve duhet të jenë të ndërveprueshme në të gjithë sistemin e drejtësisë. Mungesa e ndërveprueshmërisë mund të sjellë mungesë efikasiteti në këto sisteme. Në rastin më të keq, mund të çojë në braktisjen e zbatimit.
74. Zbatimi gjithashtu mund të vuajë nga tejkalimi. Në vend që të kërkohet të zbatohet ndryshimi teknologjik me një ritëm të matur, mund të ndërmerren hapa për të zbatuar reformën në shkallë të gjerë në një hark kohor tepër ambicioz. Sa më e madhe të jetë shkalla dhe natyra e reformës në çdo kohë, aq më i madh është rreziku që ajo të dështojë dhe, rrjedhimisht, ose të braktiset ose, në rastin më të mirë, të zbatohet pjesërisht dhe në mënyrë jo optimale.

## **(iii) Sfida e financimit**

75. Më parë CCJE ka theksuar rëndësinë themelore të financimit të duhur për t'i mundësuar gjyqësorit kryerjen e funksionit të tij si pjesë e shtetit.<sup>32</sup> Përdorimi në rritje i teknologjisë nuk duhet parë si një mjet për të ulur shpenzimet shtetërore për gjykatat dhe gjyqësorin. Zbatimi i ndryshimit teknologjik mbart me vete një sërë kostosh shoqërore që duhet të vlerësohen me kujdes dhe të buxhetohen në mënyrë efektive.
76. Financimi i vazhdueshëm i sigurt kërkohet gjithashtu kur teknologjia është në gjendje të qëndrueshme. Teknologjia duhet të mbahet e përditësuar. Gjyqtarët dhe administratorët kërkojnë rregullisht trajnim. Kjo vjen me një kosto të vazhdueshme. Për më tepër, administratorët dhe specialistët e IT-së të punësuar nga gjykatat për t'i mundësuar gjyqësorit të operojë, mirëmbajë dhe përditësojë teknologjinë, mund të kërkojnë veçanërisht rritje të pagave duke pasur parasysh aftësitë e tyre të zgjeruara dhe në fushën e IT-së. Kjo do të duhet të buxhetohet, sepse në mungesë të saj mund të mos jetë e mundur për gjyqësorin të përdorë teknologjinë në mënyrë efektive.

## **(iv) Sfida e mbrojtjes, sigurisë dhe aksesit në të dhëna**

77. Përdorimi në rritje i teknologjisë kërkon përpunim në shkallë të gjerë të të dhënave, i cili mund të ndërhyjë me të drejtat e mbrojtura sipas nenit 8 të KEDNJ, sidomos atë të mbrojtjes së të dhënave personale.<sup>33</sup> Për sa i përket projektimit, zbatimit dhe përdorimit teknologjik, këto të drejta duhet të mbrohen. Gjithashtu këto masa duhet të mbrojnë nga rreziqet e sigurisë. Kështu ndodh veçanërisht kur bëhet fjalë për të dhëna sensitive të çështjeve në procese penale dhe familjare. Zbulimi aksidental ose veprimet keqdashëse të aktorëve të këqij mund të rrezikojnë sigurinë e të dhënave, dhe veçanërisht konfidencialitetin e të dhënave të drejtësisë.
78. Dështimi i sistemit është një rrezik i mëtejshëm që lind nga përdorimi në rritje i

---

<sup>32</sup> CCJE Opinion nr. 2 (2001).

<sup>33</sup> Këshilli i Europës Konventa për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale

teknologjisë; veçanërisht i dosjeve dhe procedurave elektronike dhe sistemeve të gjurmimit dhe menaxhimit të çështjeve. Dështimi i sistemit mund t'i bëjë të dhënat e çështjes të paarrtshme. Pa sisteme adekuate dhe efektive teknologjike dhe/ose sistem rikuperimi në letër, ekziston një rrezik real për qasjen efektive dhe praktike në drejtësi.

#### **(v) Sfida e mirëqenies**

79. Përdorimi në rritje i teknologjisë mund të përbëjë kërcënim për shëndetin dhe mirëqenien afatshkurtër dhe afatgjatë të gjyqtarëve dhe përdoruesve të tjerë të gjykatave.
80. Përdorimi i gjerë i teknologjisë mund të rezultojë për shembull në lodhje, lodhje të syve, dhimbje koke, sidomos nëpërmjet përdorimit të tepërt të teknologjisë si dosje dhe procedura elektronike dhe videokonferenca. Mund të rezultojë gjithashtu në rritje të stresit, ankthit, melankolisë, uljes së hapësirës së vëmendjes dhe performancës njohëse.<sup>34</sup> Çdo efekt i tillë negativ mund të ndikojë po aq negativisht në aftësinë e gjyqtarit për të dhënë një gjykim të drejtë për palët. Gjithashtu mund të rrisë rrezikun e gabimit në gjykim.

### **VI. Kuadri ligjor dhe etik për përdorimin e teknologjisë**

81. Për të siguruar më mirë pavarësinë dhe paanshmërinë gjyqësore, CCJE vlerëson se është i nevojshëm një kuadër i qartë ligjor dhe etik për zhvillimin dhe përdorimin e teknologjisë nga gjyqësori. Ky kuadër do të bëjë më mirë të mundur që gjyqësori, si një nga pushtetet e shtetit, të mbështetet shtetin e së drejtës, ndërsa ai gjithnjë e më shumë miraton dhe përshtatet me përdorimin e teknologjisë.<sup>35</sup>
82. Shtetet Anëtare duhet të zhvillojnë një kuadër të tillë në përputhje me kërkesat e KEDNJ-së. Në mënyrë të veçantë, përdorimi i teknologjisë duhet të jetë në përputhje me pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit. Gjithashtu duhet të jetë në përputhje me të drejtën për gjykim të drejtë, siç zbatohet për proceset gjyqësore, sipas nenit 6 të KEDNJ-së. Ai gjithashtu duhet të jetë në përputhje me të drejtën për privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave,<sup>36</sup> të parashikuar nga neni 8 i KEDNJ-së, dhe të drejtën e lirisë së shprehjes për publikun, përfshirë median, të parashikuar nga neni 10 i KEDNJ. Për shkak të rrezikut të veçantë që përdorimi i teknologjisë mund të jetë i njëanshëm ose i pjesshëm në zbatimin ose efektet e tij, përdorimi i teknologjisë duhet të marrë parasysh veçanërisht nevojën për të garantuar këto të drejta në përputhje me parimin e mosdiskriminimit.
83. CCJE pranon se Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) ka zhvilluar dhe do të vazhdojë të zhvillojë praktikën e saj gjyqësore në dritën e zhvillimeve teknologjike. Për shembull, mungesa fizike në një seancë dëgjimore në një rast u kuptua si shkelje e nenit 6 të KEDNJ. Në kushte të caktuara, dhe me zhvillimin e ambienteve efektive për video-konferenca, tashmë pranohet se pjesëmarrja në gjyq nga këto ambienteve është e barabartë me praninë fizike dhe prandaj nuk është në kundërshtim me nenin 6.<sup>37</sup> Po kështu, ambientet e video-konferencave me dhoma të veçanta të sigurta mund të ofrojnë nivelin e nevojshëm të privatësisë dhe

<sup>34</sup> UNODC, Exploring Linkages between Judicial Well-Being and Judicial Integrity (2022) në [12]; A. Bullock, A. Colvin, & M. Jackson, *Zoom fatigue in the age of COVID-19*, Journal of Social Work in the Global Community, (2022) 7(1), 1–9

<sup>35</sup> CCJE Opinion nr. 18 (2015), paragrafët 20-22

<sup>36</sup> Shih, për shembull, *Avilkina kundër Rusisë* [2013] GJEDNJ 515 në [45]-[46].

<sup>37</sup> *Marcello Viola kundër Italisë* (Nr. 45106/04) (5 tetor 2006) në [67]-[77].

konfidencialitetit në proceset penale që i pandehuri të marrë këshilla ligjore në përputhje me kërkesat e nenit 6, kur më parë kjo teknologji nuk ishte e mundur.<sup>38</sup>

84. Brenda kuadrit të përgjithshëm të parashikuar nga KEDNJ dhe mbrojtjes kombëtare të të drejtave themelore, përdorimi i teknologjisë nga gjyqësori duhet të mbështetet nga një bazë e përshtatshme ligjore.<sup>39</sup> Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur teknologjia përdoret në sistemet mbështetëse të gjyqësorit që ofrojnë ndihmë për vendimmarrjen gjyqësore. Është po aq e rëndësishme kur bëhet fjalë për mbrojtjen e të dhënave personale.
85. Për të ofruar mbrojtje dhe siguri efektive të të dhënave dhe rregullim pa kompromentuar pavarësinë gjyqësore, shtetet anëtare duhet të krijojnë, aty ku nuk ekzistojnë tashmë, organe kombëtare mbikëqyrëse për mbrojtjen e të dhënave për gjyqësorin kur veprojnë në cilësinë e gjyqësorit. Këto organe duhet të krijohen brenda gjyqësorit. Dispozita ligjore gjithashtu mund të hartohet për të caktuar përgjegjësinë për sigurinë dhe integritetin e teknologjisë dhe të dhënave të përdorura nga gjyqësori.
86. Legjislacioni gjithashtu duhet të parashikojë kalimin në rritje drejt përdorimit të teknologjisë nga gjyqësori. Ai duhet të parashikojë veçanërisht mirëmbajtjen, sipas nevojës, e mjeteve alternative jo të bazuara në teknologji për të aksesuar gjyqësorin dhe proceset ligjore, për ata që nuk janë në gjendje të aksesojnë ose të përdorin teknologjinë në mënyrë efektive.
87. Është veçanërisht e rëndësishme që të parashikohet vazhdimi i seancave dëgjimore jo të bazuara në teknologji. Ndërsa audio dhe/ose videokonferenca mund të jetë e përshtatshme për disa seanca, nuk do të jetë domosdoshmërisht e përshtatshme për seanca dëgjimore të gjata, ose për ato që përfshijnë marrjen dhe vlerësimin e dëshmimeve nga dëshmitarët, ndër të tjera.
88. Rregullat procedurale duhet të parashikojnë kur gjyqësori, i cili zakonisht duhet të jetë i pranishëm në sallë/ndërtesën e gjykatës gjatë seancave dhe vetëm përjashtimisht të marrë pjesë në seanca në distancë nga diku tjetër, të mund të ushtrojë diskrecion për të përcaktuar që seancat duhet të mbahen nëpërmjet mjeteve teknologjike ose tradicionale. Gjithashtu ato duhet të parashikojnë kur është e nevojshme që pjesëmarrësit në procese, duke përfshirë anëtarët e gjyqësorit, të marrin pjesë personalisht në gjykatë kur seancat zhvillohen nëpërmjet teknologjisë audio ose video.
89. Brenda kuadrit të përgjithshëm ligjor, rregullat procedurale duhet të parashikojnë vendimin gjyqësor të përdorimit të teknologjisë për qëllime specifike. Shtetet anëtare duhet të kenë rregulla të ndryshme për forma të ndryshme procesesh. Çdo diskrecion i parashikuar në rregullat procedurale, dhe për këtë çështje në legjislacion, në lidhje me përdorimin e teknologjisë në procese të veçanta duhet të ushtrohet në mënyrë gjyqësore dhe jo administrative.

## **VII. Parimet e përgjithshme në lidhje me teknologjinë në sisteme të drejtësisë**

90. Mbi të gjitha, përdorimi i teknologjisë duhet të respektojë natyrën e procesit gjyqësor. Së pari, shumë vendime gjyqësore janë vendime diskrecionare, të bazuara në fakte

---

<sup>38</sup> *Sakhnovskiy kundër Ruisisë* [2010] GJEDNJ 1673; *Sakhnovskiy kundër Ruisisë* ( [2018] GJEDNJ 966; *Gorbunov kundër Ruisisë* [2016] GJEDNJ 231.

<sup>39</sup> Udhëzime të CEPEJ për videokonferencën në procese gjyqësore (2021) në 8.



të veçanta të një çështjeje të caktuar. Së dyti, gjyqtarët luajnë rol thelbësor në zhvillimin e ligjit. Ata nuk zbatojnë thjesht rregulla fikse dhe të pandryshueshme. Gjyqtarët duhet të jenë në gjendje të korrigjojnë ose të shtojnë ligjin nëse ai ka mangësi ose kërcënon të prishë zbatimin e ligjit në çështje specifike. Teknologjia nuk duhet të hyjë në fushën e drejtësisë. Teknologjia nuk duhet të dekurajojë apo të pengojë mendimin kritik të gjyqtarëve pasi kjo mund të çojë në ngecje të zhvillimit ligjor dhe në gërryerje të sistemit të mbrojtjes ligjore. Prandaj, mjetet teknologjike duhet të respektojnë procesin e vendimmarrjes gjyqësore dhe autonominë e gjyqtarëve.

91. CCJE vlerëson se parimet e mëposhtme duhet të udhëheqin projektimin, zbatimin dhe përdorimin e ardhshëm të teknologjisë për të mbështetur gjyqtarët. Ato synojnë të jenë në përputhje me Kartën Etike Europiane për Përdorimin e Inteligjencës Artificiale në Sistemet Gjyqësore dhe Mjedisin e tyre (2018) dhe Udhëzimet e CEPEJ për Dosjet Elektronike në Gjykatë (e-dosje) dhe Digjitalizimin e Gjykatave (2021).
92. CCJE mbështet përdorimin e teknologjisë që ndihmon gjyqtarët. E bën këtë kur kjo teknologji respekton plotësisht parimet e mëposhtme. Prandaj, qëllimi kryesor i këtyre parimeve është sigurimi më i mirë i qasjes efektive dhe praktike në drejtësi në përputhje me pavarësinë e gjyqësorit dhe sundimin e ligjit. Ato synojnë të ruajnë dhe të rrisin legjitimitetin gjyqësor dhe besimin te gjyqësori. Parimet janë si vijon:
  - (i) **Sundimi i ligjit:** teknologjia duhet të përdoret vetëm për të mbështetur dhe përmirësuar sundimin e ligjit. Prandaj, ajo duhet të dizajnohet, të zbatohet dhe të përdoret brenda dhe bazuar në një kuadër etik dhe ligjor të qartë, përgjithësisht të zbatueshëm dhe të aksesueshëm nga publiku që është në përputhje me të drejtat themelore të garantuara nga Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).
  - (ii) **Pavarësia dhe paanshmëria gjyqësore:** teknologjia duhet të mbështesë gjyqësorin në kryerjen e rolit të tij kushtetues në mënyrë të drejtë dhe efikase. Projektimi dhe funksionimi i saj duhet t'u nënshtrohen garancive, duke përfshirë legjisllacionin dhe/ose rregullat e gjykatës, sipas nevojës për të siguruar pavarësinë dhe paanshmërinë gjyqësore si institucionale ashtu edhe individuale në të gjitha fazat e proceseve gjyqësore. Këto garanci duhet t'u përshtaten nevojave të procedurave, pavarësisht nga natyra e tyre. Teknologjia, në mënyrë specifike, nuk duhet të përdoret për të parashikuar vendimmarrjen e një gjyqtari individual.
  - (iii) **Autonomia gjyqësore:** teknologjia mund të përdoret vetëm për të mbështetur dhe ndihmuar gjykatat dhe gjyqësorin në menaxhimin dhe vendimmarrjen e duhur në procese. Vendimmarrja, në mënyrë të shprehur dhe të nënkuptuar, duhet të kryhet vetëm nga gjyqtarët. Ajo nuk mund të delegohet ose të bëhet nga ose nëpërmjet teknologjisë. Autonomia gjyqësore duhet të respektohet me përdorimin e teknologjisë.
  - (iv) **Mbikëqyrja gjyqësore:** për të ruajtur konsistencën e saj me pavarësinë, paanshmërinë dhe autonominë gjyqësore, gjyqtarët qoftë nëpërmjet Këshillave Gjyqësorë apo tjetër, duhet të përfshihen në blerjen, projektimin dhe kontrollin e teknologjisë. Ata gjithashtu duhet të bien dakord për prezantimin dhe zbatimin e saj. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur përgjegjësia për administrimin e gjykatave i takon Ministrive të Drejtësisë ose është një çështje e partneritetit ndërmjet gjyqësorit dhe Ministrisë së Drejtësisë. Duhet të parashikohet gjithashtu që gjyqtarët të mbahen të përditësuar me inovacionet teknologjike

për të lehtësuar përfshirjen e tyre efektive dhe, kur është e nevojshme, pranimin për përdorimin e teknologjisë së re dhe në zhvillim.

- (v) **Qasja dhe cilësia:** teknologjia duhet të përforcojë dhe të përmirësojë qasjen efektive dhe praktike në drejtësi për të gjithë anëtarët e shoqërisë. Duhet të promovojë qasjen si në drejtësinë gjyqësore, në përputhje me nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ashtu edhe në zgjidhjen me marrëveshje. Promovimi i qasjes kërkon domosdoshmërisht që teknologjia të jetë e një cilësie të lartë. Kur qasja në teknologji nuk është praktike, duhet të ofrohet një alternativë e përshtatshme ekuivalente.
- (vi) **Ndërveprueshmëria dhe përmirësimi i vazhdueshëm:** për të realizuar dhe promovuar plotësisht efikasitetin dhe efektivitetin në qasjen në drejtësi, teknologjia duhet të jetë e ndërveprueshme në të gjitha pjesët e sistemit të drejtësisë. Ajo duhet të projektohet dhe të vihet në punë në mënyrë që të mund t'i nënshtrohet përmirësimit të vazhdueshëm. Prandaj duhet të zbatohen mekanizma për të parashikuar vlerësime efektive nga përdoruesi për përdorimin e saj.
- (vii) **Pilotimi:** efekti i zhvillimit të teknologjisë nuk mund të vlerësohet gjithmonë plotësisht përpara zbatimit. Për t'u mbrojtur nga pasojat e paparashikuara dhe për të lejuar gjithashtu një vlerësim të duhur të inovacionit teknologjik, përdorimi i teknologjisë së re duhet t'i nënshtrohet pilotimit përpara se të zbatohet plotësisht.
- (viii) **Projektimi dhe funksionimi jodiskriminues:** teknologjia që mbështet dhe ndihmon gjyqësorin duhet të projektohet dhe të funksionojë në mënyrë aktive që të jetë jodiskriminuese. Duhet të jetë në përputhje me projektimin dhe funksionimin e përqendruar të përdoruesit. Duhet të merren parasysh nevojat e të gjithë përdoruesve, qofshin gjyqtarë, avokatë, anëtarë të publikut, në mënyrë që të sigurohet që projektimi dhe funksionimi i teknologjisë nga gjyqësori të jetë i drejtë. Prandaj, ekipet e projektimit duhet të jenë ndërdisiplinore.
- (ix) **Transparenca dhe kuptueshmëria:** projektimi teknologjik duhet të jetë transparent dhe i kuptueshëm nga përdoruesit. I tillë është veçanërisht rasti kur përdoret AI dhe ku teknologjia përdoret për të ndihmuar menaxhimin e çështjeve dhe vendimmarrjen gjyqësore.
- (x) **Llogaridhënia:** natyra dhe përdorimi i teknologjisë duhet t'i nënshtrohet mekanizmave të duhur të llogaridhënies. Projektimi dhe zbatimi i saj duhet të jenë në gjendje t'i nënshtrohen kontrollit nga shteti, sidomos kontrollit legjislativ dhe autorizimit, dhe shoqërisë civile. Përdorimi i saj në proceset individuale duhet t'i nënshtrohet kontrollit nga palët në proces, në përputhje me parimet e njoftimit në kohë, adversaritetit dhe llogaridhënies gjyqësore.
- (xi) **Integriteti, siguria dhe mbrojtja e të dhënave:** teknologjia duhet t'i nënshtrohet masave efektive organizative dhe teknike, në përputhje me standardet e zbatueshme të kërkuara nga çdo ligj i zbatueshëm për mbrojtjen e të dhënave, për të ruajtur integritetin dhe sigurinë e të dhënave të përdorura nga gjyqësori në mënyrë që të ruhet besimi në, dhe legjitimiteti i, gjyqësorit. Këto masa duhet të parashikojnë kontrole të ndryshme të aksesit në këto të dhëna për gjyqtarët, administratën e gjykatave, palët, përfaqësuesit ligjorë dhe publikun.
- (xii) **Transparenca dhe privatësia:** masat për të ruajtur integritetin, sigurinë dhe

mbrojtjen e të dhënave nuk duhet të rrezikojnë aftësinë e gjyqësorit për të siguruar parimin e publicitetit, sidomos çdo derogim të vlefshëm nga ai ose kufizim të tij për të mbrojtur privatësinë ose të drejtën ose interes tjetër, në përputhje me nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

- (xiii) **Financimi:** teknologjia, prezantimi i saj, mirëmbajtja, përdorimi nga administrata e gjykatës dhe gjyqtarët dhe përditësimi duhet të financohen në mënyrën e duhur gjatë gjithë jetëgjatësisë së saj. Financimi duhet të mbështesë projektimin dhe zbatimin efektiv të saj. Gjithashtu duhet të jetë i përshtatshëm për të mbështetur mirëmbajtjen efektive të saj nga administrata gjyqësore dhe përmirësimin e vazhdueshëm. Prandaj duhet të krijohen mekanizma për të siguruar kapjen efektive të të dhënave operacionale për të lehtësuar vlerësimin e funksionimit dhe efektit të teknologjisë mbi gjyqësorin dhe përdoruesit e gjykatave nga gjyqësori dhe ata që janë përgjegjës për administrimin e gjykatave.
- (xiv) **Trajnimi dhe funksionaliteti:** për të siguruar që teknologjia të përdoret në mënyrë sa më efikase dhe efektive, gjyqësori dhe administrata e gjykatave duhet të informohen dhe të trajnohen mbi natyrën dhe përdorimin efektiv të teknologjisë së përdorur nga gjyqësori.

# Fjalorth

Termet e mëposhtme janë të përdorura në Opinion:

- a. **Inteligjenca artificiale (AI):** replikimi i aftësisë njohëse të njeriut dhe vendimmarrjes nga një makineri. Në këtë Opinion, forma kryesore e AI që përmendet është ajo e të mësuarit të makinerive. Ky është një proces që përdor modele (algoritme) statistikore, matematikore të cilat u mundësojnë kompjuterëve të zbulojnë modele matematikore brenda grupeve të mëdha të të dhënave (informacioneve) pa udhëzime të shprehura. Zbulimi i modelit është ajo që nënkuptohet me "të mësuarit". Kjo analizë më pas, për shembull, shërben si bazë për klasifikimin e të dhënave, renditjen e të dhënave ose vendimmarrjen.
- b. **Audio-konferenca:** një sistem që përdor teknologjinë, qoftë telefonike apo digjitale nëpërmjet internetit, për të lehtësuar një takim, si një seancë gjyqësore, nëpërmjet audios.
- c. **Sisteme të menaxhimit të çështjeve:** sisteme elektronike që mbështesin administrimin e drejtësisë. Ato përfshijnë mekanizma të automatizuara që: lejojnë që dokumentet dhe provat të ngarkohen dhe t'u jepen palëve dhe gjyqtarit nëpërmjet dosjeve elektronike, lehtësojnë caktimin e orarit të proceseve përmes mjeteve të planifikimit, promovojnë respektimin e kërkesave procedurale, duke përfshirë monitorimin e respektimit; promovojnë shpërndarjen dhe menaxhimin efikas të burimeve gjyqësore, duke përfshirë ngarkesën e punës gjyqësore.
- d. **Sisteme të gjurmimit të çështjeve:** sisteme elektronike që lejojnë përdoruesin të marrë informacion në lidhje me proceset. Ky informacion përfshin: numrin e identifikimit të gjykatës për çdo çështje, emrat e palëve në proces, detajet e përfaqësuesve ligjorë të palëve në proces; detajet e dokumenteve të depozituara në proces dhe të çdo urdhri apo vendimi të marrë, dhe detajet e seancave të planifikuara dhe ecurinë e çështjes.
- e. **Mjetet e të dhënave:** mjete elektronike për përpunimin dhe menaxhimin e informacionit dhe sigurimin e aksesit në legjislacion dhe vendime gjyqësore (praktikë gjyqësore). Ato mund të sigurohen nga shteti ose nga sektori privat.
- f. **E-nxjerrja ose e-zbulimi:** nxjerrja e dokumenteve elektronike (e-dokumente) në procese gjyqësore.
- g. **E-dosje dhe procedura:** një mjet online, i cili lejon palët dhe avokatët të ngarkojnë në gjykatë dhe të shkëmbejnë versione digjitale të dokumenteve dhe provave të çështjes.
- h. **Sistem ekspertize:** një formë e AI. Mjet online i përbërë nga dy pjesë: një bazë njohurish, e cila përbëhet nga rregulla dhe fakte të njohura; dhe një motor deduksioni. Motori i deduksionit zbaton rregulla për faktet e ditura, përmes aplikimit të arsytimit deduktiv, për të dalë në fakte të reja. Ai synon të replikojë vendimmarrjen e ekspertizës njerëzore.
- i. **Seanca dëgjimore hibride:** një seancë ku një ose më shumë nga pjesëmarrësit (gjyqtar, palë, dëshmitarë) marrin pjesë ndërkohë që janë të pranishëm në një ndërtesë fizike të gjykatës. Pjesëmarrësit e tjerë marrin pjesë nëpërmjet njërës ose

të dyjave mënyra audio dhe videokonferencës.

- j. **Sistem mbështetës i gjyqësorit:** një zgjerim i sistemit të menaxhimit të çështjeve, i cili u siguron gjyqtarëve mjete të ndryshme për të promovuar menaxhimin efektiv dhe praktik të proceseve, p.sh. nëpërmjet ndihmës për plotësimin e dokumenteve, vendimeve ose urdhrave ose nëpërmjet promovimit të ndërgjegjësimit gjyqësor për afatet e ardhshme procedurale. Kjo gjithashtu përfshin, për shembull, automatizimin e dokumenteve përmes përdorimit të pemës së vendimit.
- k. **I lexueshëm nga makineria:** strukturimi i informacionit, si ai në një dokument ose, veçanërisht në një vendim, i cili mund të përpunohet nga një program kompjuterik. Mjetet me të cilat dokumentet mund të përpunohen me anë të të mësuarit të makinerive.
- l. **Kodimi parashikues:** një formë e teknologjisë parashikuese, e cila lehtëson shqyrtimin e dokumenteve dhe e-dokumenteve si pjesë e një zbulimi ose procesi e-zbulimi në proceset gjyqësore. Teknologjia është trajnuar për të njohur dokumentet që mund të zbulohen përmes përdorimit të të mësuarit të makinerive në mënyrë të mbikëqyrur dhe të përforcuar.
- m. **Seanca dëgjimore në distancë:** një seancë dëgjimore që mbahet përmes audio-konferencës ose video-konferencës ku asnjë nga pjesëmarrësit nuk është i pranishëm në ndërtesën fizike të gjykatës gjatë seancës.
- n. **AI mbështetës (ose ndihmës):** përdorimi i AI për të mbështetur menaxhimin e çështjeve dhe vendimmarrjen gjyqësore.
- o. **Videokonferenca:** një sistem që përdor teknologjinë që siguron transmetimin e njëkohshëm të imazheve audio dhe vizuale të personave për qëllim të komunikimit sinkron.